

youth  
tirana  
euro pean  
youth  
capital 2022



## **8 Programe dhe Mijëra Mundësi për Fuqizimin dhe Aktivizimin e të Rinjve**

Më 21 nëntor 2019, diçka e mrekullueshme i ndodhi rinisë së kryeqytetit tonë.

Tirana u shpall Kryeqyteti Evropian i Rinisë për 2022 (EYC 2022) – një titull që jepet nga Forumi Rinor Evropian (European Youth Forum) për të fuqizuar të rinjtë, për të nxitur pjesëmarrjen e tyre në shoqëri dhe për të forcuar identitetin evropian.

Nga transporti publik dhe infrastruktura tek programet social-kulturore, arsimore dhe pjesëmarrja në politikëbërje, titulli Kryeqyteti Evropian i Rinisë fton qytetet të ri-mendojnë se si të angazhojnë dhe përfshijnë të rinjtë në të gjitha aspektet e jetës së qytetit.

Në vitin 2019, Kongresi Rinor Kombëtar në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës aplikuan dhe u shpallën fitues për titullin Tirana Kryeqyteti Evropian i Rinisë 2022.

Puna e përbashkët e Kongresit Rinor Kombëtar dhe Bashkisë Tiranë u vlerësua për fokusin tek të rinjtë dhe programin që synon të sjellë një perspektivë rinore në të gjithë aspektet e jetës së qytetit.

Tirana u shpall “Kryeqyteti Evropian i Rinisë” në 2019, në Amiens, Francë, dhe stafetën zyrtare të këtij titulli e mori më 17 Dhjetor 2021 në Klaipeda, Lituani.

Në 2022, “Tirana Kryeqyteti Evropian i Rinisë” sjell për rininë shqipëtare 8 programe dhe mijëra mundësi për fuqizimin dhe aktivizimin e tyre. Nën sloganin **Activate Youth**, këto programe shërbejnë për t’i dhënë prioritet fushave, veprimtarive, projekteve dhe iniciativave rinore të këtij viti kaq të veçantë për Tiranën dhe gjithë Shqipërinë.

# Çfarë synojmë?

Ky program synon të fuqizojë rininë duke krijuar mundësi të reja e duke i dhënë asaj një dimension evropian. Ndër të tjera, programi synon:

- t të sjellë ndryshime pozitive;
- t të inkurajojë pjesëmarrjen aktive;
- t të promovojë vullnetarizmin;
- t të nxisë identitetin evropian;
- t të promovojë dhe të mbrojë diversitetin dhe gjithëpërfshirjen;
- t të fuqizojë organizatat rinore;
- t të rrisë investimet për të rinjtë;
- t të transformojë qytetin në një pikë ndërkombëtare takimi;
- t të krijojë rrjetëzime dhe sinergji mes të rinjve nga e gjithë Evropa.



# Njihuni me 8 Programet e Tirana Kryeqyteti Evropian i Rinisë 2022



Rinia prodhon Ekonomi Krijuese dhe Novacion

Kreativiteti është një aset dhe potencial ende i pashfrytëzuar në sferën ekonomike shqiptare dhe duhet konsideruar si energjia frymëzuese dhe aftësia që nxit shumë individë, përfshirë të rinjtë, të ndërmarrin nisma të reja. Qëllimi i këtij programi është të mbështesë transformimin e kreativitetit të të rinjve në kulturë dhe novacion bazuar kryesisht në shfrytëzimin e teknologjisë por jo vetëm.





## Rinia krijon Kulturë


Kultura ka forcë të transformojë vizionin e një shoqërie, të forcojë komunitetet lokale dhe të krijojë një ndjenjë identiteti dhe përkatësie tek njerëzit e të gjitha moshave, por në veçanti tek brezi i ri. Ky program synon të nxisë rininë për të eksploruar mënyrat se si kultura dhe arti mund të vihen në dobi të jetës së tyre të përditshme, por edhe të kthehen në një mjet të fuqishëm për ndryshime pozitive afatgjata.



## Rinia zhvillon Kapacitete

Investimi në formimin, arsimimin e të rinjve dhe rritjen e kapaciteteve të tyre është një faktor i domosdoshëm për zhvillimin e kapaciteteve rinore. Duke kombinuar një sërë aktiviteteve të ideuara në mënyrë kreative, duke trajtuar aftësitë e nevojshme për sfera të ndryshme të jetës, ku të rinjtë jo vetëm do të trajnohen por do të jenë protagonistë aktivë në rritjen e kapaciteteve të bashkëmoshatarëve, programi do të mbështesë të rinjtë në zhvillimin e aftësive, inteligjencës emocionale dhe forcimin e potencialit të tyre.





## Rinia dhe Pjesëmarrja

Jeta e të rinjve është ndër më të prekurat nga zhvillimet lokale dhe ato globale. Qëllimi i këtij programi është të rrisë perceptimin dhe besimin e të rinjve në potencialin e tyre si agjentë ndryshimi, duke inkurajuar përfshirjen e tyre më të lartë në proceset vendimmarrëse, në nivel qendror e lokal.



## Rinia dhe Diversiteti

Koncepti i diversitetit shtrihet në themelet e trashëgimisë dhe identitetit Evropian, duke përfshirë pranimin dhe respektin ndaj multikulturalizmit. Qëllimi i këtij programi nuk është vetëm edukimi i të rinjve në të paturin e një këndvështrimi më pozitiv ndaj një shoqërie me tipare të larmishme, por për t'i kthyer ata në nxitësit kryesorë të multikulturalizmit dhe tolerancës.







## Rinia është Evropiane

Rinia shqiptare është segmenti më pro-Evropian i shoqërisë sonë. Qëllimi i këtij programia është nxitja e identitetit të përbashkët Evropian duke promovuar vlerat demokratike dhe duke rritur ndërgjegjësimin për rëndësinë e punës së përbashkët për të ardhmen e familjes Evropiane.



## Rinia dhe Eco-Health

Shëndeti i njerëzve është mjaft i ndërlidhur me shëndetin e mjedisit përreth tyre. Programi Eco - Health promovon një mënyrë të shëndetshme jetese tek të rinjtë dhe synon të rrisë ndërgjegjësimin e tyre për rëndësinë thelbësore të një ekosistemi të shëndetshëm. Të rinjtë do të inkurajohem të bëhen udhëheqës aktivë të ndryshimit për një shoqëri më të shëndetshme, të zhvilluar dhe të qëndrueshme.





## Rinia dhe Hapësirat Rinore

Për rininë, hapësirat publike janë pjesë e domosdoshme e zhvillimit të tyre. Ato lehtësojnë ndërveprimin social duke ndihmuar në krijimin e një përkatësie në komunitet. Ky program synon të nxisë zbatimin e projekt ideve që ofrojnë hapësira fizike dhe infrastruktura shtesë e miqësore për të rinjtë në qytet, të cilat janë autonome, të hapura, të sigurta dhe të aksesueshme nga të gjithë.

**Dëshironi të mësoni  
më shumë mbi aktivitetet  
që do të ndodhin në kuadër  
të programit Tirana EYC 2022  
përgjatë këtij viti?**

Vizitoni faqen zyrtare:  
[www.tiranaeyc2022.al](http://www.tiranaeyc2022.al)  
Email: [info@krk-teyc2022.al](mailto:info@krk-teyc2022.al)

